

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shoqëria "KL-ED KABELL" sh.p.k

Administrator Dokleat Ademi

Durrës, Lagjja 13, Rruga Pavarësia, Plazh, Sektori Iliria, Pallati Firma Zoto, Hyrja 34
NIPT: K52112501F

KONTRATË SHITJE KAPITALI

Sot, me datë, 12.08.2021 (dy mijë e njëzetë e një), në selinë e shoqërisë që ndodhet në **Durrës, Lagjja 13, Rruga Pavarësia, Plazh, Sektori Iliria, Pallati Firma Zoto, Hyrja 34**, janë prezent, palet kontratuese me cilesite si me poshte:



PALA SHITËSE: Dokleat Ademi, i biri i Bashkim-it, i datëlindjes 14.05.1975, lindur në Kavajë, banues në Lagjen 3, Rr. "Egnatia", pallati Aleks, Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, posedues i kartës së identitetit me numër 034912474/11.10.2019, zotërues i 100% të kapitalit në shoqërinë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k, me NIPT- **K52112501F** dhe.

PALA BLERËSE : ILDA DOÇI, e bija e Shaban dhe e Ildishane, e lindur ne Tiranë me date 15.12.1980 dhe banues ne Rr. "Horizonri", Lagjia 18, Durrës madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, posedues i kartës së identitetit me numër 034136507/15.04.2019, dhe nr. personal **I06215172L**.

Palët bien dakort si më poshtë vijon:

NENI 1- KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Pala shitese, z. **Dokleat Ademi**, eshte ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar "**KL-ED KABELL**" sh.p.k, e cila e është një person juridik shqiptar, e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, në Qendren Kombetare te Regjistrimit, me nr. NIPTI (NUIS): **K52112501F** dhe zotëron 1 pjesë, që përbën 100% te kapitalit te shoqërisë me vlerë në para 100.000 (njëqind mijë) Lekë, dhe vlere në natyrë **14.630.000,00** Lekë. Ky fakt vërtetohet dhe nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar te lëshuar nga QKR, per Shoqërinë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k, që i bashkelidhet kësaj kontrate.
- 1.2 Me Vendimin e asamblesë së ortakut të vetëm nr. 1, date 12.08.2021, te shoqërisë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k, nder te tjera është vendosur:
- 1.2.1 Kalimin e shoqërisë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k nga shoqëria e ortakut të vetëm në shoqëri me dy ortak, nëpërmjet shitjes nga ortaku **Dokleat Ademi tek Ilda DOÇI**, 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k me vlerë në para 7.365.000 Lek (Shtatë million e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) Lek. Shitja e kësaj pjese të kuotës do të bëhet me këtë çmim total pavarësisht mënyrës së rritjes së kapitalit të nënshkruar deri më sot nga ortaku i shoqërisë. Për sa më sipër, ortakut deklaroi se nuk ka asnjë pretendim ndaj njera tjetres, pretendim për të shkuarën apo edhe në të ardhmen.
- 1.2.2 Pas kalimit të pronësisë dhe kryerjen e kontratës së shitjes për kalimin e pronësisë, nga ortaku **Dokleat Ademi tek Ilda DOÇI**, e cila përbën 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k me vlerë në para 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek, kapitali i shoqërisë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k me NUIS: K52112501F do të **zotërohet si mëposhtë:**
- Ortaku **Dokleat ADEMI**, zotërues i 1 pjese, me pjesmarrje në përqindje 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "**KL-ED KABELL**" sh.p.k me vlerë në para 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek;
 - Ortaku **Ilda DOÇI**, zotërues i 1 (një pjesë) me pjesmarrje në përqindje 50 %



(pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë "KL-ED KABELL" sh.p.k me vlerë në para para 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek.

NENI 2- OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate shitje është kalimi i pronësisë nëpërmjet shitjes 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë "KL-ED KABELL" sh.p.k, me vlerë në para në 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek, nga ortakut Doklead Ademi tek ortakut Ilda DOÇI. Palët bien dakort që, shitja e kësaj pjese të kuotës do të bëhet me cmimin total prej para vlerë në para 7.365.000 Lek (Shtatë million e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) Lek, në vlerën e kapitalit të nënshkruar të derdhur për këtë pjesë. Për sa më sipër, palët deklarojnë se bien dakort dhe nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëra tjetrës, pretendim për të shkuarën apo edhe në të ardhmen.

NENI 3 – BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kesaj kontrate shitje neni 705 e vijues te Kodit Civil, Ligji 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuara, rregullimet e bera në statutin të shoqërisë "KL-ED KABELL" sh.p.k dhe në aktin e themelimit te kesaj te fundit dhe vendimi nr.1, datë 12.08.2021 i ortakut të shoqërisë.

NENI 4- TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

4.1 Me nënshkrimin e kesaj kontrate shitesi **Doklead ADEMI** zhvishet nga pronesia e 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë vlerë në para 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek, dhe bleseri **Ilda DOÇI**, bëhet pronar dhe zoteron 1 (një) pjesë që përbën 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë "KL-ED KABELL" sh.p.k, me vlerë në para 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek, pasi e ka e nënshkruar plotësisht kete pjesë të kapitalit.

4.2 Me nënshkrimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash, shoqëria "KL-ED KABELL" sh.p.k, behet shoqeri me dy ortakë, kapitali i se ciles përbëhet nga dy kuota, eshte nënshkruar plotësisht dhe zoterohet nga ortakët:

4.2.1 Doklead Ademi, i biri i Bashkim-it, i datëlindjes 14.05.1975, lindur në Kavajë, banues në Lagjen 3, Rr. "Egnatia", pallati Aleks, Durrës, zotëruar i **1 (një) pjese**, me pjesmarrje në për qindje 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë "KL-ED KABELL" sh.p.k, me vlerë në para 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek;

4.2.2 ILDA DOÇI, e bija e Shaban dhe e Ildishane, e lindur ne Tiranë me date 15.12.1980 dhe banues ne Rr. "Horizonri", Lagjia 18, Durrës, zotëron **1 (një) pjese**, që përbën 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë "KL-ED KABELL" sh.p.k, me vlerë në para 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek dhe vlerë në natyrë 7.315.000 (shtatë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lek .

NENI 5- TE NDRYSHME

5.1 Kesaj kontrate i bashkelidhen dhe jane pjese përbërese e sja dokumentacioni si me poshtë vijon: 1. Ektrakt i regjistrimit tregtar "KL-ED KABELL" sh.p.k.; 2. Vendimi nr. 1, date 12.08.2021 i Asamblesë së ortakëve te Shoqërisë "KL-ED KABELL" sh.p.k; 3. Kopje e dokumnetacionit identifikues te paleve.

5.2. Kjo eshte nje kontrate shitje kuotash e perpiluar ne kater kopje dhe pasi lexohet me ze te larte dhe gjendet ne perputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese, nënshkruhet rregullisht prej tyre si vijon.

PALET KONTRAKTUESE

SHITËSI

Doklead ADEMI

BLERËSI

Ilda DOÇI